

Nr.^{4996/3}..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 05.03. 2024

VENDIMI I AKSIONERIT TË VETËM TË SHOQËRISË**“SENA - SOLAR ENERGY OF ALBANIA sh. a”****Nr. 6, Datë 05.03.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të Statutit të **SENA - Solar Energy of Albania** sh.a dhe Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë **SENA - Solar Energy of Albania** Nr. 4... datë 28.02.2024 përcjellë pranë Asamblesë me shkresë Nr. 3/S Prot....., Aksioner i vetëm në mbledhjen e datës 05.03.2024;

VENDOSI

- Miratimin e Raportit të Audituesit të Pavarur “Mbi verifikimin e procedura për zvogëlimin e kapitalit aksioner/të rregjistruar” të shoqërisë **SENA – Solar Energy of Albania sh.a.** për vitin ushtrimor 2021 dhe 2022”, si më poshtë
 - Zvogëlimi i kapitalit aksioner të shoqërisë “**SENA SOLAR ENERGY of ALBANIA**” (**SENA**) Sh.a, me **35,618,710.00** Lek (*tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dhjetë*) nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, duke mbajtur të pandryshuar numrin e aksioneve, në 10 (*dhjetë*) aksione.
 - Kapitali i Regjistruar i shoqërisë “**SENA SOLAR ENERGY of ALBANIA**” (**SENA**) sh.a. pas zvogëlimit do rezultojë **435,961,000** Lek (*Katërqind e tridhjetë e pesë milion e nëntë qind e gjashtëdhjetë e një mijë*) deri në datën e këtij raporti.
 - Ky kapital zotërohet **100%** nga aksioneri “Korporata Elektroenergjitike Shqipëtare” (**KESH**) sh.a.

Kapitali Aksionar i shoqërisë, pas zvogëlimit do të rezultojë si më poshtë:

Vlera e Kapitalit sipas QKB ishte: 471,579,710.00 Lek, bëhet: 435,961,000.00 Lek

Vlera nominale e Aksioneve sipas QKB ishte: 47,157,971.00 Lek/aksion, bëhet: 43,596,100.00 Lek/aksion

Nr. aksioneve mbetet i pandryshuar në: **10 Aksione**

- SENA - Solar Energy of Albania sh.a.** duhet të depozitojë Raportin e miratuar në regjistrin e shoqërive tregtare.
- Ngarkohet **SENA - Solar Energy of Albania sh.a** për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR AKSIONERIN E VETËM
KESH sh.a
ADMINISTRATORI
Ergys Verdho

